

Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri

Tetor 2019


Tiranë, më 26 Nëntor 2019: Hyrjet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj në territorin shqiptar, në muajin Tetor 2019, janë 866.121.

Krahasuar me Tetor 2018, ky tregues rezulton me rritje 10,2 %. Në Tetor 2019, hyrjet e shtetasve të huaj në vend janë 387.152. Krahasuar me Tetor 2018, ky numër është rritur me 14,7 %.

Numri i shtetasve të huaj të hyrë në vendin tonë përgjatë dhjetë muajve të 2019 është 5.849.154, duke u rritur me 8,3 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2018. Në Tetor 2019, ndër vendet që kanë hyrjet më të larta të shtetasve në Shqipëri, Spanja ka pasur rritjen më të madhe me 62,4 %, ndërsa uljen më të ndjeshme e ka pasur Polonia me 4,5 %.

Përgjatë dhjetë muajve të 2019, ndër vendet që kanë hyrjet më të larta të shtetasve në Shqipëri, Zvicra ka pasur rritjen më të madhe me 19,9 % ndërsa uljen më të ndjeshme e ka pasur Polonia me 14,2 %.

Fig. 1 Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri



Daljet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj nga vendi, gjatë muajit Tetor 2019, janë 888.218 duke shënuar një rritje me 12,3 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Daljet e shtetasve shqiptarë nga territori i Shqipërisë, gjatë muajit Tetor 2019, janë 495.089. Krahasuar me Tetor 2018, ky numër

është rritur 5,0 %. Daljet e shtetasve të huaj nga territori i Shqipërisë gjatë muajit Tetor 2019, janë 393.129. Krahasuar me Tetor 2018, ky numër është rritur 23,1 %.

Numri i shtetasve shqiptarë të dalë nga territori i vendit tonë përgjatë dhjetë muajve të 2019, është 4.956.344 duke u rritur 9,2 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Tab. 1 Lëvizjet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj

Periudha	Tetor 2018	Tetor 2019	Ndryshimi vjetor (%)	Janar- Tetor 2018	Janar- Tetor 2019	Ndryshimi vjetor (%)
Hyrje Gjithsej	786.089	866.121	10,2	9.766.194	10.512.120	7,6
Shqiptarë	448.486	478.969	6,8	4.366.768	4.662.966	6,8
Të Huaj	337.603	387.152	14,7	5.399.426	5.849.154	8,3
Dalje Gjithsej	791.058	888.218	12,3	10.116.592	10.609.672	4,9
Shqiptarë	471.582	495.089	5,0	4.537.760	4.956.344	9,2
Të Huaj	319.476	393.129	23,1	5.578.832	5.653.328	1,3

Tab. 2 Hyrjet e shtetasve të huaj

Shtetet	Tetor 2018	Tetor 2019	Ndryshimi vjetor (%)	Janar- Tetor 2018	Janar- Tetor 2019	Ndryshimi vjetor (%)
Kosovë	79.631	92.010	15,5	1.944.985	2.096.989	7,8
Maqedonia e Veriut	48.584	52.448	8,0	602.831	690.758	14,6
Greqi	46.393	50.260	8,3	458.765	498.482	8,7
Itali	27.754	30.386	30,4	387.397	412.256	6,4
Angli	9.675	12.111	25,2	109.601	117.508	7,2
Mali i zi	34.601	37.254	7,7	298.920	308.016	3,0
Poloni	2.601	2.483	-4,5	152.773	131.035	-14,2
SHBA	8.705	8.427	-3,2	108.357	109.923	1,4
Spanjë	1.393	2.262	62,4	23.611	27.245	15,4
Gjermani	12.357	16.716	35,3	134.198	157.142	17,1
Zvicër	3.867	5.471	41,5	50.731	60.816	19,9
Të tjera	62.042	77.324	24,6	1.127.257	1.238.984	9,9
Gjithsej	337.603	387.152	14,7	5.399.426	5.849.154	8,3

Tab. 3 Hyrjet e shtetasve të huaj sipas qëllimit

Periudha	Tetor 2018	Tetor 2019	Ndryshimi vjetor (%)	Janar- Tetor 2018	Janar- Tetor 2019	Ndryshimi vjetor (%)
Hyrje Shtetas të Huaj	337.603	387.152	14,7	5.399.426	5.849.154	8,3
I. Personale	328.235	376.415	14,7	5.327.047	5.765.206	8,2
1. Pushime, vizitë tek të afërm etj.	314.489	360.790	14,7	5.158.160	5.582.096	8,2
2. Trajtim shëndetësor	36	27	-25,0	203	532	162,1
3. Qëllime fetare	44	39	-11,4	674	717	6,4
4. Udhëtarë transit	13.666	15.559	13,9	168.010	181.861	8,2
II. Biznes dhe profesionale	9.368	10.737	14,6	72.379	83.948	16,0

Tab. 4 Lëvizjet e shtetasve sipas mënyrës udhëtimit

Periudha	Hyrje gjithsej			Dalje gjithsej		
	Ajër	Det	Tokë	Ajër	Det	Tokë
Tetor 2018	109.316	48.308	628.465	118.198	47.568	625.292
Tetor 2019	130.728	53.853	681.540	141.741	52.585	693.892
Ndryshimi vjetor (%)	19,6	11,5	8,4	19,9	10,5	11,0
Janar- Tetor 2018	1.257.555	715.140	7.793.499	1.271.426	743.718	8.101.448
Janar- Tetor 2019	1.405.668	751.331	8.355.121	1.426.985	781.025	8.401.662
Ndryshimi vjetor (%)	11,8	5,1	7,2	12,2	5,0	3,7

Metodologji

Qëllimi i publikimit të hyrjeve dhe daljeve të shtetasve shqiptarë dhe të huaj sipas mënyrës së udhëtimit (me det, ajër, tokë dhe pikave kufitare) është matja e disa treguesëve statistikorë që lidhen me turizmin.

Përkufizime

Hyrjet: Përfshijnë të gjitha hyrjet e personave në pikat kufitare (me ajër, det dhe tokë).

Hyrjet janë një koncept që i referohet të gjitha mbërritjeve. Një person që viziton disa vende njëkohësisht gjatë një viti llogaritet çdo herë si një hyrje e re.

Daljet : Përfshijnë të gjitha daljet e personave nga pikat kufitare (me ajër, det dhe tokë).

Daljet masin fluksin e shtetasve që lënë vendin e referencës. Një person që lë vendin e referencës disa herë gjatë një viti llogaritet çdo herë si një dalje e re.

Vizitor: Për qëllime të statistikave të turizmit, termi “vizitor” nënkupton “një person që udhëton në një vend të ndryshëm nga vendi ku ai banon, për një periudhë më pak se 12 muaj dhe qëllimi kryesor i këtij udhëtimit në vendin e vizituar nuk është ai i një veprimtarie fitimprurëse”.

Qëllimi i udhëtimit të vizitorëve dhe turistëve përfshin vizita për:

Qëllime personale të cilat grupohen në:

1. Pushime, vizitë tek të afërm, etj.;
2. Trajtim shëndetësor;
3. Qëllime fetare;
4. Udhëtarë tranzit.

Kategoria e biznesit që përfshin të gjitha bizneset dhe aktivitetet profesionale jashtë ambjentit të zakonshëm.

Burimi i të dhënave: Të dhënat janë administrative dhe sigurohen nga Ministria e Punëve të Brendshme (Policia e Shtetit, Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit).

Të dhënat janë paraprake dhe subjekt rishikimi të vazhdueshëm. Për më shumë referohu: <http://www.instat.gov.al/al/dokumentimi/cil%C3%ABsia-statistikore/> politika e revizionimit statistikor.

Diferencat statistikore misdis hyrje-daljeve të shtetasve Shqiptarë apo të huaj vijnë kryesisht nga:

- Ligjit nr.71/2016 "Për Kontrollin Kufitar", neni 17 "Lehtësimi i verifikimeve Kufitare", ku gjatë sezonit turistik apo fluksit të shtuar, në momentet e hyrjeve të shtetasve në kufi, nuk regjistron shtetasit në hyrje;
- Procedurat lehtësuese që aplikohen për banorët e zonave kufitare të cilët kalojnë kufirin për arsye të aktivitetit të tyre tregtarë, kur kalojnë disa herë brenda ditës, nuk regjistrohen në hyrje;
- Dy-shtetësia që zotërojnë një pjesë e mirë e Shqiptarëve të cilët në momentin e kalimit të kufirit mund të deklarojnë shtetësi të ndryshme në dalje nga ajo në hyrje, etj.